



**215 DITË  
RRETHUAR**

**E MARTË** 11 GUSHT 2009  
WWW.TEMA.AL

# TemA

**30  
LEKË**

Gazetë e përditshme  
Numër 2740 | Viti IX



Nga e hëna në të enjte, në "Vizion Plus", ora 23:00

**OPINION 11** **PSE TË MOS HAPET  
KUTIA E PANDORËS**  
NGA FEHMI RAMADANI

**OPINION 11** **MARRËDHËNIE  
TË RREZIKSHME**  
NGA FRANCO VENTURINI

**ANALIZA 8-9** **PSE NUK FESTON  
E DJATHTA?**  
NGA LORENC VANGJELI

**SPORTI 14** **NJË KËRKIM HISTORIK I KULTURËS  
SË NOTIT MODERN NË SHQIPËRI...**  
NGA BESNIK DIZDARI

## EDITORIAL

### Shqipëria liberale?

Augustin Palokaj

MEDIAT NË KROACI rrallëherë shkruajnë për Shqipërinë. Madje për zgjedhjet e fundit as që ka pasur njoftime në Kroaci. Këto ditë vere, sikur edhe viteve të tjera, gazetatat në Kroaci numërojnë turistët e huaj që vijnë për të pushuar në këtë vend sepse turizmi, sidomos në këtë krizë financiare e cila e ka kapluar edhe Kroacinë, është një degë shpëtimi. Ditët e fundit të korrikut dhe ditët e para të gushtit kanë nxitur një optimizëm se turizmi në Kroaci edhe këtë vit do të jetë në nivelin e vitit të shkuar për nga numri i vizitorëve të huaj, diku rreth 11 milionë këtë vit, por të ardhurat do të jenë më të vogla për shkak se turistët shpenzojnë më pak.

Në Kroaci ndodhi ndërrimi në krye të qeverisë, me urgjencë është rritur taksat në paga që nga opozita dhe populli quhet „haraç“ dhe të gjitha këto masa për të mbyllur disi vrimën në buxhetin e shtetit për këtë vit dhe për të evituar ndonjë aranzhim me Fondin Monetar Ndërkombëtar, i cili do ta vështirësonte situatën sociale edhe në Kroaci, ku për nga mesatarja njerëzit janë më të pasur sesa qytetarët e shumë vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.

Por në Kroaci ka edhe probleme sociale të natyrës tjetër. Ende... ■ 10

Komentoni në webfaqen tonë [www.tema.al](http://www.tema.al)

## AKTUALITETI

# PS: Do të ngremë komision hetimor për vrasjen e katër oficerëve të policisë

Një nga objektet e punës së Parlamentit të jetë edhe ngritja e një komisioni për të verifikuar veprimtarinë e Policisë së Shtetit, në mënyrë të veçantë në këto 2-3 ngjarje të rënda të kohëve të fundit. Kemi rreth tre muaj që është ndarë nga jeta ish-deputeti i PS-së, Fatmir Xhindi dhe nuk flitet asnjë fjalë për të. Nuk janë të rastësishme ngjarjet e rënda që kanë ndodhur, pasi janë vrarë qytetarët në mes të qytetit, janë vrarë funksionarë të lartë të shtetit ... ■ 3

## DAJTI: TENTUAN TË MË VRASIN. GJYKATA E LË NË QELI



**ANTENA BRENDA** FAMILJES

FAQE 2

## Sandri bisedon me Taçin për të blerë Italia Uno

### AKTUALITET 5

**Taçipina ose Taçi Mashtruesi, nofka e tifozëve të Bolonjës për ish-kamerierin që e pasuroi politika**

### KRONIKA 4

**Shpërthimi i nënstacionit elektrik, plagosen tre elektrikistë**

### EKONOMI 7

**Biznesi në krizë, 37% e kredive për të paguar pagat dhe detyrime**

### KULTURA 12-13

**Një perlë poetike në letërsinë shqipe**  
Nga Shefqet Dibrani

Gazeta "TemA" s'ka më adresë. Çdo informacion mund të dërgohet me e-mail ose në numrat mobile që janë në gazetë





## Një perlë poetike në letërsinë shqipe

Përmasat e poezisë artistike të Gjekë Marinaj tek "Lutje në ditën e tetë të javës", vëllim poetik, botuar nga Shtëpia Botuese "Faik Konica", Prishtinë 2008

**Nga Shefqet Dibrani**

**PËRMBLEDHJA POETIKE** "Lutje në ditën e tetë të javës", e Gjekë Marinaj, është një vepër monumentale. Poezia që gjejmë aty është një poezi artistike, komplekse, e shkruar në një metodë sinteze unike, ku shtresimet metaforike i kompletojnë edhe më mirë vlerat e saj letrare. Është fjala për ato vlera që destinohen nga autori si vizione kredo të shënuara në "pentagrame me më shumë se pesë vija".

Përmbledhja poetike "Lutje në ditën e tetë të javës", është e mbushur me figurshmëri analitike, me ide e vizione poetike, në të cilat breshërojnë një mori konceptesh filozofike të shoqëruara nga një risi motivuese për të ndërthurur një poezi të re, moderne dhe me elemente nismëtare në letërsinë shqipe. Për të parë se sa mund të lejojë gjuha poetike, ai ka bërë mjaft manovrimet artistike në poezinë e tij, por për të konkretizuar këtë mendim po citojmë tre vargje ndarëse të një poezie më të gjatë:

"Natyrshtëm, natyrishtë, bëmë dashuri në natyrë!.../ Natyrishtë, bëmë dashuri në natyrë, natyrshtëm!.../ Bëmë dashuri në natyrë, natyrshtëm natyrishtë", (faqe 67). Ky sintezim i stërholluar i fjalës artistike, ky kolorit ideartistik i motiveve dhe përjetimeve asociacione kah një vlerë moderne, që mund ta arrijnë vetëm poetët që kanë një eksperiencë në këtë fushë, dhe nga ata që në rrethin ku jetojnë ballafaqohen me vlera të njëmendta poetike, dhe përballen me një konkurrencë të mirëfilltë letrare e artistike në përgjithësi. Këtë konstatim po e ilustruam edhe me disa vargje nga poezia "Purgatori", ku në mes tjerash poeti shkruan: "Ajo që një lule e freskët/Që priste lejen e mëngjesit për të çelur/Ai që i dashuri i saj!.../ Pa i lexuar njëri-tjetrit asnjë pjesë nga tregimi/Rreth Lancelotit dhe Guiniverës,/ U bënë pjesë e një dashurie të ndaluar!.../ Ç'rëndësi ka se kush i spiunoi të dashuruarit!.../ Madje as Dantja/Nuk hodhi dritë mbi dramën e tyre./ Nuk e trajtoi atë/ Si një nga kualitetet e romancës tragjike, (faqe 25).

Me të vërtetë përmbledhja poetike "Lutje në ditën e tetë të javës" e ka avancuar vlerën e poezisë së sotme shqipe e cila krijohet në hapësirën



"Gruaja e moshuar duke u lutur" - Nicolaes Maes

shqiptare dhe më gjerë. Ky vëllim kaq i përpunuar na vetëdijeson se kemi të bëjmë me një krijues me vlera të dallueshme që do t'i japë emër pozitiv letërsisë shqipe. Individualiteti i tij krijues, impulset krijuese, aftësia e vrojtimit, imagjinata e edukuar janë vetëm disa nga tiparet që përbëjnë poezinë e këtij libri, duke kompletuar edhe më tej individualitetin krijues të Gjekë Marinaj: "Sa për ta/Dantja më mirë ta linte/të pabotuar "Komedinë Hyjnore"/ Ata do ia shtonin edhe një rreth të ri "Purgatorit"/ Qenë aq njerëzorë/Sa mëkatarët e vërtetë do të i rënkoin me keqardhje", (po aty, f. 25).

Poezitet edhe si vlerë letrare, edhe si vlerë poetike, por edhe si vlerë estetike ndërtojnë korrelacionin poetik sepse duke i mbrujtur idetë, ai i ka dhënë një lloj zëri specifik poezisë. Dimensionet dhe qasjet kanë një strukturë integrale mjaft funksionale duke realizuar në planin artistik dhe atë estetik idenë për të konceptuar më mirë poezinë në shërbim të artit dhe letërsisë në përgjithësi: "Marlowe më ka bërë shumë nder me Faustus/Tani i

njoh mirë vlerat e shpirtit, kostot e dijës./ E dalloj më pastër vijën e lakuar të ekuatorit/Dhe njësimin humano-kafshëror të centaurëve", (faqe 19).

### Evolucion në ndërdijen e poetit

Poeti Gjekë Marinaj me një pasion të rrallë, që nuk mund të gjendet aq lehtë diku tjetër, iu ka përkushtuar letërsisë, e veçmas krijimit të poezisë të cilës me vokacionin e vet i jep shije artistike, dhe në planin estetik ka realizuar "strategjinë e mësymjes" dhe "sistemimin mbrojtës", qoftë edhe "nga forca shtytëse e gazeve", (po aty, f. 19).

Në poezinë më të re të këtij poeti artikulohe më mirë dhe sintetizohen më qartë idetë e motivet që e bëjnë poezinë e këtij libri më të avancuar, shikuar nga dy librat paraprak: "Nga gjinjët zbrakë u rrodhi/shkujdesur filozofia për gjykimin human". Kurse elementet e ndikimit ambiental ai i materializon vetëm si elemente shërbyese, si shkas për t'u futur pastaj thellë e më thellë në esencën e problemit, në bren-dësinë e tij për të parë se si zhvillohet, përse ky apo ai fenomen ndryshon

“

...jo gjithkush është i aftë ta kapë pa deficite poezinë e këtij vëllimi poetik. Një vështirësi, kjo, që mund ta has kushdo që përpiqet për ta komentuar a deshifruar në thelb kuptimin dhe simbolizmin e poezisë së Marinaj. Ky fakt i shton bindje mendimit tim se vëllimi poetik "Lutje në ditën e tetë të javës" i Gjekë Marinaj, me sukses do t'i sfidojë kohërat dhe do të mbetet si një perlë poetike në letërsinë shqipe

shkruarit, kurse ndikimet e rrethit a shoqërisë mund të merren vetëm si refleksione a asociacione të rastit që kanë ndikuar pozitivisht për krijimin e poezisë estetike.

Tani më, Gjekë Marinaj ka kohë që jeton i shkëputur nga vendlindja dhe njerëzit e tij. E, nëse në librat e parë të tij motivet dhe elementet e vendlindjes i gjejmë si mall a kujtim, në librin e fundit më shumë e ndeshim si motiv, si një mendim i suvatuar me petkun filozofik, ku autori ka arrit të tejkaloi me sukses mënyrën e përshkrimit si ndijim, tashti ai merret më shumë me zhvillimin e procesit duke analizuar faktorët që çojnë deri në shpërthimin motivor të një procesi. Pra edhe këto elemente që i theksuam janë përdorur me maturi duke e bërë lëndën dhe materien e librit funksionale, të dobishme dhe shërbyese; elemente këto që i gjejmë me bollëk te poezitë: "Komshinjtë, në Brut", "Këngëtarja e bjeshkëve", "Shkodrës", "Rrëfimi i Rozafës" e ndonjë tjetër.

### I lodhur nën mbikqyrjen e paqes vetëm në letër...

Poetin Gjekë Marinaj gjithmonë e ka shqetësuar fati i njeriut. Preokupimet e tij në shoqëri kanë qenë gjithmonë në funksion të këtij qëllimi, pasi duket se poeti është "i lodhur nën mbikqyrjen e paqes vetëm në letër". Gjekë Marinaj si poet, si intelektual e si njeri, vazhdimisht e ka preokupuar hapësira dhe shoqëria, sidomos kur është ndeshur me atë ambientin e shoqërisë së çrregulluar, streset dhe ngarkesat e shoqërisë, tensionet e përditshmërisë, ndasitë racore e hapësinore, kufizimet dhe devijimet e shumta të individit a të shoqërisë në emër të "shkatërrimit të njërit si mundësi e qetësisë së tjetrit".

Elemente të tjera që përshkruajnë përmasat e refleksioneve, ndijimet dhe përjetimet e shumta qoftë nga ikjet e shumta, qoftë nga kthimet e traumatizuara, janë konfliktet e paevitueshme, përmasat e theksuara të varfërisë, vobekësisë të cilat janë të mëdha në shoqëritë e sotme moderne, por që mendojnë vazhdimisht poetin, s'ka dyshim. Ai vazhdimisht bën përpjekje që të ndikoi dhe për aq sa mundet, pse jo edhe t'i ndryshoi, gjithmonë në dobi të njeriut, në shërbim të së ardhmes dhe në shërbim të botës njerëzore: "Të më falë Militoni, por për mua do të ishte më mirë/të jesh shërbëtor në parajsë se sa sundues në ferr", (faqe 19).

Ana tjetër e kësaj poezie, siç theksuam edhe diku më lart, është solidarizimi me të shtypurit dhe popujt e robëruar, zëri i tij poetik e intelektual >>



«*është kundër shtypjes, racizmit dhe diskriminimit, kundër luftërave dhe shkatërrimeve me përmasa që shkaktojnë dhembje, varfëri dhe diskriminim. Ai gjithmonë, edhe si intelektual, është për investime kulturore, arsimore, sportive, në fushën e turizmit a sektorin industrial, pra për fusha që i afrojnë njerëzit, jo ato që i ndajnë që shkatërrojnë dhe që krijojnë hendeqe e kufij të pakalueshëm.*

Në poezinë e Gjekë Marinajt gjejmë nota sentimentale e melankolike, vargje dhembje e mallëngjimi për vende e popuj, se poeti është *“loti më i bukur i Etiopisë/gjithmonë qan dhe qesh me te”*, por vargjet më elegjiake i dalin kur shkruan për Shqipërinë e tij: *“Sikur të kisha imunitet shpirtëror në Shqipëri./Do mbaja për vete pa turp kripën e lotëve”*, (faqe 116). Po ashtu të këtij niveli janë poezitë e vargjet që ua kushton intelektualëve e shkrimtarëve, me veprat e të cilëve është brumosur, siç është poezia *“Sot u lind Frederik Reshpja”*, e veçmas dallojnë vargjet elegjiake dhe plot mall kur shkruan për prindërit, kur kujton vaujtet e tyre ose mallin e nënës. Poezitë: *“Duart e nënës”, “Në ditëlindjen e nënës”, “Himn për prindërit e mi”, etj.*, marrin sekuenca më të theksuara përjetimi si një akt i lartë poetik e njerëzor.

Jeta sociale dhe degradimi moral i individit, në veçanti dhe i shoqërisë në përgjithësi, shihen në një prizëm krejt ndryshe, prandaj revolta e tij poetike mund të merret, mbase e arsyeshme edhe kur shkruan se është *“i lodhur nën mbikëqyrjen e paqes vetëm në letër”*. Janë disa nga temat, motivet dhe ndijimet poetike për të cilat mendojmë se e krijojnë atë anën burimore e kuptimore të vëllimit poetik *“Lutje në ditën e tetë të javës”*, dhe me këtë gjithmonë konstatojmë se Gjekë Marinaj ka ndërtuar personalitetin e tij poetik mbi një rrafsh, mbi një pllajë ku shtrihet gjerë e gjatë bota e tij kuptimore e të të gjitha refleksioneve poetike siç i gjejmë të dy poezitë emblematike të këtij vëllimi poetik: *“Lutjet e së dielës”* dhe *“Poetët fillojnë nga e para të hënën”*.

#### Marinaj: Java i ndan poetët në shtatë fletë të holla drite

Kjo pllajë, ky rrafsh jo vetëm hapësinor, por edhe filozofik, i ka mundësuar këtij poeti që të zgjerojë gamën e tij krijuese, ku reflektohen e thyhen idetë e shumta dhe prej më të ndryshmeve. Kuptime e botëkuptime të cilat edhe nëse janë trajtuar më parë, përsëri marrin konotacione të reja dhe do të kenë një funksionalitet të ri, qoftë si ide apo si veprim. Ta zëmë: *“A ka më shumë/shpirtra/ apo zgjedhime/folja/jap”*, ose tek një poezi tjetër kur shkruan se *“Java i ndan poetët në shtatë fletë të holla drite”* dhe *“i detyron që të fillojnë*

*prapë nga e para të hënën”*. I cituam jo pa qëllim vetëm dy vargjet e kësaj poezie për t'i lënë mundësinë lexuesit që të kuptojnë esencën filozofike të rrotacionit ditor që bëhet brenda javës, i cili më shumë se kushtdo tjetër është zbrëthyer nga vetë poeti në 14 vargjet tjera, që krijojnë atë strukturën organike të poezisë *“Poetët fillojnë nga e para të hënën”*. Baza kuptimore që është krijuar, jo vetëm në këtë poezi të theksuar, është një lëndë e re, një proces në fillimet e tij, ku përmasat e kontekstit kanë mundësinë e pakufizueshme qoftë me refleksione poetike apo thjesht me ato poezitë filozofike e meditative që dalin si nëntekste nëpër shumë poezi të këtij vëllimi.

Poeti, mund të konsiderohet edhe si një observator i mirë, siç e ndeshim te poezia *“Vija ndarëse me Emily Dickinson-in”* a ndonjë tjetër, pasi ai në mënyrë konstante ka regjistruar shumë lëvizje e dukuri (qofshin ato natyrore a filozofike) që shpesh për syrin dhe mendjen e njeriut janë të pakapshme. Jo rrallë këto ndryshime i kanë nxjerr poetit imazhe ekspresive, apo në raste të tjera si shprehje revoltuese, që shprehin drejtpërdrejt raportin e poetit, krijuesit dhe intelektualit me shoqërinë, përkatësisht me turmën njerëzore e cila edhe pse mund të jetë në ballë të tyre, gjithmonë është treguar e paafte të drejtojë ato procese, që pastaj për t'i kanalizuar e orientuar në shërbim të shoqërisë, në funksion të së ardhmes duhet së paku ta dimë se: *“A ka më shumë/germa/a keqkuptime/koncepti/L i r i?”*. S'ka dyshim që Gjekë Marinaj është nga poetët e rrallë (ndoshta në mesin e shqiptarëve më i rralli), që fuqinë e observimit e ka më të zhvilluar; ai mbi këtë observim i ndërton refleksionet poetike, mesazhet dhe metaforat e kreshpëruara që rrjedhin si një ujëvarë (ta zëmë në Ujëvarat e Mirushës, në Kosovën tonë të dashur) apo shpesh ngajnë edhe me ajsbergët që, siç ka thënë vetë poeti në vëllimin paraprak, ta *“ngrijnë oqeanin e ëndrrave kudo midis të sotmes dhe të nesërmes”*.

#### Originaliteti

Poezia e Gjekë Marinajt është një shembull për poezinë e sotme shqipe. Përvoja tij krijuese e sidomos ajo formuese, si poet e si pedagog, duhet besuar, dhe më shumë e kemi borxh për ta afirmuar si një shembull i mirë, që besueshëm e besueshmërisht është në funksion të shumë ndikimeve poetike në krijimet e sotme shqipe. Kur flas kështu, nuk mendoj që ky autor të kopjohet, sepse më pas do të kemi vetëm një *“origjinal”* që e pasojnë si *“kopja I”, “kopja II”, “kopja III”* e kështu me radhë, por të mësohet se si ky autor ka zgjedhur simbolin,



Libri "Lutje në ditën e tetë të javës" i Gjekë Marinaj

si e ka përdorur metaforën, si e ka shtruar idenë, si i ka materializuar shumë fenomene që poezinë e bëjnë poezi, dhe t'i iket tipit të poezisë revolucionare, të poezisë realsocialiste, poezisë që himnizon kultin e *“trimit”* të pa qenë, tipit të poezisë mekanike që më shumë ngjan me vargëzime për të shprehë mllef e duf, se sa poezi e përmasave që hasim te poezia e këtij poeti në përgjithësi, e veçmas te *“Lutje në ditën e tetë të javës”*.

Originaliteti i poezisë së Gjekë Marinajt është një tipar tjetër që është ndërtuar falë përvojës së tij krijuese, po më shumë falë përditshmërisë akademike, ku njihet mirë me kahet e poezisë së përparuar botërore, që tashmë pranohen edhe si avangardë e lëvizjeve më të fuqishme botërore jo vetëm në fushën e poezisë e të letërsisë, por edhe në fushat e tjera të artit e muzikës, zhvillimit e emancipimit qytetar. Te poezia e Gjekë Marinajt, hasim edhe një gjuhë e cila shpreh revoltë, po aq sa është e drejtpërdrejtë, sa do që herë pas here mbulohet edhe me formën e ironisë: *“Si një korb i zitetur në tokë, (ku) humuszohet vdekja”*. Tek ky autor edhe në librin paraprak e kemi ndeshur këtë formë, por jo kaq të avancuar, dhe kështu duke përdorur revoltën si mënyrë shprehje ai ka shprehur shumë gjëra e veprime për të cilat pretendon se nuk janë duke

vajtur mbarë. Por në revoltën e Gjekë Marinajt ndeshim një lloj shqetësimi tjetër, jo personal por universal. E para; për të gjitha çrregullimet brenda etnosit shqiptar, dhe e dyta për të gjitha çrregullimet me përmasa botërore në emër të *“shkatërrimit të njerit si mundësi e qetësisë së tjetrit”*.

Te kjo e fundit, Gjekën e gjejmë në krye të misionit, si një misionari në mbrojtje dhe në përkrahje të asaj shtrese që ka nevojë, që është e diskriminuar, nga diskriminimi racial e fetar. Jo vetëm në këtë libër, por gjithkund e gjithkah poezia e këtij poeti, kur shkruan për këto dukuri, ka revoltë dhe si përgjigje për fituesit, përkatësisht gjeneratorët e krizave ai thotë se: *“për mua do të ishte më mirë/të jesh shërbëtor në parajsë se sa sundues në ferr”*, (e cituar më lart, f. 19).

Deri sa në poezinë e shumë poetëve të mërguar, qofshin shqiptar a të huaj, ndjehet shqetësimi i tjetërsimit a tëhuajzimit, te ky poet sikur manifestohet e kundërta ngase është i vetëdijshëm për misionin që ka marrë në shërbim të poezisë dhe letërsisë shqipe, karshi kulturave dhe konkurrencës absolutisht të pa përbalueshme. Por poeti s'ka kohë të mendojë, *“se mbi fletën e bardhë/sytë i ka kthyer në syze”* e aq më pak të mbijell defetizëm e të hap dilema të të

gjithë bashkëkombësit e tij që jetojnë dherave të shkapërderdhur, dhe në të njëjtën kohë disa pre tyre janë edhe autor librash.

Poezia e Gjekë Marinajt kryekëput ka për motiv jetën, ngadhënjimin dhe lumturimin, dritën dhe triumfin e përmasave të paparashikueshme. Këtë e shpreh më së miri te poezitë lirike që ia kushton Dusites, gruas së tij që e quan *“poezi”*, personit që e ka shoqëruar në përpjekjet dhe krajjat e jetës duke e bymyer shpirtërisht që ai ti sfidojë më lehtë të papriturat dhe vështirësitë eventuale në jetë: *“Faleminderit për pjesën tënde të fytyrës sime, / Trëndafili im i vetëm përherë në çelje, / Epiqendra e dashurisë time gjithnjë në rritje”*, (faqe 53). Gjeka është ndër të paktët poet që jetën e shikon kështu në sy dhe e din pse duhet gjallëruar. Dhe këtë gjallërim e ka më shumë në kuptimin filozofik se sa si një gjallërimin sa për të jetuar si qenie fizike. Kjo gjë atij i ka shërbyer për të krijuar një bllok të tërë poezish, optimiste që shprehin ngadhënjimin dhe triumfin e poetit, tamam *“me krenarinë e një lapsi/të mprehur hollë/vetëm ecën/derisa mbarohet duke shkruar diçka”*, (faqe 126).

Po ashtu, te poezia e këtij poeti ndjehet e përjetohet prirja për të regjistruar me tepër të bukurën, progresivën se sa të keqen e të shëmtuarën. Këtë e shohim edhe te poezitë: *“Moment frojidian”, “24 orë dashuri”, “Kjo është ajo vajza”, “Më ëmbël seç puth vesa bjeshkën” etj.* Siç duket, poeti si në jetë ashtu dhe në poezi merret më shumë me të bukurën, me artistiken, me pozitiven dhe kjo dukuri i është bërë parim jetësor. Sublimimi i refleksioneve personale sikur përngjet edhe më shumë me afrimin e poetit me poezinë, sepse kur refleksionet e tija personale të shprehura në poezi iu shërbejnë edhe të tjerëve, ose ngjasojnë me ato të tjerëve, mendoj se kjo është arritje specifike në poezi. Duhet shtuar se në poezitë e këtij vëllimi, gjejmë figura të shumta nga mitologjia, referenca që kanë të bëjnë direkt me personazhe të caktuara nga librat e autorëve me ndikim, si dhe krahasime të tjera me vende a pole tokësore që autori i ka parë e përjetuar. Kjo do të thotë se jo gjithkush është i aftë ta kapë pa deficite poezinë e këtij vëllimi poetik. Një vështirësi, kjo, që mund ta hasin kushtdo që përpigjet për ta komentuar a deshifruar në thelb kuptimin dhe simbolizmin e poezisë së Marinajt. Ky fakt i shton bindje mendimit tim se vëllimi poetik *“Lutje në ditën e tetë të javës”*, i Gjekë Marinajt, me sukses do t'i sfidojë kohërat dhe do të mbetet si një perlë poetike në letërsinë shqipe.

Nice, Francë, verë 2009.

(Shënim: Titulli dhe mestitujt janë redaksionalë-Dh.H.)